



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.11, datë 03.03.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME
BERAT SH.A.

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 03.03.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a.",

Konstaton se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a me shkresën nr.188 prot. datë 21.02.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Berat sh.a në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (**VKM nr. 302**).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a (NUIS M23511002O) është themeluar më datë 04.11.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe Bashkitë Berat me 23.01%, Dimal me 5.39%, Poliçan me 3.58%, Kuçovë me 12.32%, Skrapar me 4.7%.
- b) Shoqëria Rajonale UK Berat sh.a ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 155 928 banorë të Bashkive Berat, Skrapar, Poliçan, Dimal, Kuçovë.
- c) Drejtues teknik i shoqërisë znj. Evis Allajbe është diplomuar në Universitetin Politeknik në Inxhinieri hidroteknike në vitin 2005 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Berat sh.a, të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Berat sh.a është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

- 1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a me (NUIS M23511002O), në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;
- 2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor – Pelivan Sinaj
 - b) Drejtues Teknik – Evis Allajbe

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat sh.a janë Bashkitë Berat, Skrapar, Poliçan, Dimal, Kuçovë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat sh.a për marrjen e këtij vendimi.
7. Vendimi i KKRR nr.143, datë 27.11.2020 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Dimal sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.318, datë 20.08.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Skrapar sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.475, datë 09.12.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Poliçan sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.518, datë 21.12.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a.”, shfuqizohet;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani